



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 60 datë 30.12.2015

Për

**“PJESËMARRJEN E BASHKISË SË TIRANËS NË INSTITUCIONIN FINANCIAR
JOBANKË “CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA” SH.P.K DHE MIRATIMIN E
AKTIT TË THEMELIMIT E STATUTIT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika I/I, shkronja “ç”, pika 1/VI, shkronja “b”, nenit 10, pika 3/III, shkronja “c”, nenit 32, shkronja “d”, dhe nenit 33, pika 3 të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar); nenit 3, pika 1, nenit 10, pika 2 dhe nenit 85, pika 1 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 30.04.2014 për “Miratimin e fondit dhe të projektit “Fondi në ndihmë të SME-ve”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë së Tiranës, si ortak që zotëron 25% të kapitalit themeltar, në institucionin financiar jo-bankë me emrin “Crimson Finance Fund Albania” sh.p.k, i licensuar nga Banka e Shqipërisë me licensën nr. 34, datë 02.10.2015.
2. Të miratojë Aktin e Themelimit dhe Statutin të institucionit financiar jo bankë “Crimson Finance Fund Albania” sh.p.k, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij të përfaqësojë Bashkinë e Tiranës për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Ngarkohet për zbatimin këtij vendimi Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI